



PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2024
ME ZGJEDHJE – SESIONI I
SKEMA E VLERËSIMIT

LËNDA: Qytetari dhe Psikologji

Varianti B

Pyetjet me alternativa

Pyetja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigja e saktë	A	D	A	A	C	B	B	B	C	A
Pyetja	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26
Përgjigja e saktë	C	C	A	D	A	B	A	C	D	D

Pyetjet me zhvillim

Shënim: Për pyetjet me zhvillim, nxënësi fiton pikët, edhe nëse jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta.

Qytetari

Pyetja 11
Model përgjigje

4 pikë

Disa nga mekanizmat që parashikon Kodi i Punës për të mbrojtur të drejtat e punonjësve janë:

- organizimi në sindikata për të mbrojtur interesat e përbashkët të punonjësve.
- negociatat me punëdhënësit.
- ndërmjetësimi i shtetit.
- grevat të cilat realizohen nga sindikatat kur nuk janë në kundërshtim me ligjin.
- etj.

4 pikë nëse përcakton katër mekanizma;
3 pikë nëse përcakton tri mekanizma;
2 pikë nëse përcakton dy mekanizma;
1 pikë nëse përcakton një mekanizëm;
0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12
Model përgjigje

3 pikë

- E drejta e protestës, është një e drejtë që bënë pjesë në kategorinë e lirisë negative. Kjo e drejtë mbron individin prej shtetit. Punonjësit po protestojnë kundër projektligjit pasi nuk e konsiderojnë të drejtë këtë vendim.
- E drejta sociale dhe ekonomike; E drejta e kategorisë së dytë.
- Protestat janë të ligjshme pasi janë një mjet për të shprehur mospajtim. Në shtetet demokratike sovratiteti i takon popullit ndaj protesta është një e drejtë që ushtrohet nga populli në këtë rast.
- Përmes protestave mund të realizohen ndryshimet dhe janë mjete të ligjshme të mospajtitimit në një shoqëri demokratike.

3 pikë nëse përgjigjet për tri kërkesat;

2 pikë nëse përgjigjet për dy kërkesat;

1 pikë nëse përgjigjet për një kërkesë;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 13 **3 pikë**
Model përgjigje

- Përcaktimi i gjinisë, për profilin e juristes, është diskriminues, limitues. Sipas Kodit të Punës nuk duhet të ketë diferencime për shkak të gjinisë; Profesion i juristit mund të realizohet si nga burrat dhe nga gratë në mënyrë të padiferencuar.
- Përcaktimi i moshës është kufizues për një target grup tjetër që përmbushin kriteret e tjera, por janë mbi 35 vjeç. Sipas Kodit të Punës nuk duhet të ketë diferencime për shkak të moshës lidhur me vendin e punës. Pozicion i punës mund të realizohet në mënyrë të suksesshme edhe nga mosha të tjera.
- Gatishmëria për të punuar edhe të shtunave, në fundjavë, bie ndesh me të drejtën e punonjësve për të pushuar. Çdo punonjës nuk mund të punojë më shumë se 40 orë në javë (48 orë maksimumi, duke konsideruar edhe orët shtesë).
- Pabarazia në procesin e rekrutimit, për shkak se u diskriminua lidhur me besimin fetar.

3 pikë nëse vlerëson tri shkelje;

2 pikë nëse vlerëson dy shkelje;

1 pikë nëse vlerëson një shkelje;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 14
Model përgjigje

3 pikë

- Qëndrimi gjatë para ekranit mund të ndikojë në probleme të shëndetit fizik: koha e gjatë e qëndrimit përpara ekraneve mund të sjellë probleme të shikimit, dhimbje të kokës dhe dhimbje të qafës, shpinës. Për më tepër, një mënyrë jetese sedentare mund të çojë në obezitet dhe probleme të tjera shëndetësore.
- Ekspozimi ndaj përmbajtjeve të papërshtatshme mund të ndikojë në shëndetin mendor: fëmijët mund të ekspozohen ndaj përmbajtjeve të dhunshme, seksuale ose të tjera të papërshtatshme kur kalojnë kohë në ekrane. Ky ekspozim mund të çojë në ankth, depresion dhe probleme të tjera të shëndetit mendor.
- Zvogëlimi i aftësive të ndërveprimit social dhe komunikimit: Fëmijët që kalojnë kohë të tepërt në ekran mund të kenë më pak mundësi për t'u përfshirë në komunikim ballë për ballë dhe ndërveprim social. Kjo mund të çojë në mungesë të aftësive sociale, vështirësi në formimin dhe mbajtjen e marrëdhënieve, gjithashtu ndikon në uljen e ndjeshmërisë e inteligjencës emocionale.

- Etj.

3 pikë nëse analizon tri pasoja;

2 pikë nëse analizon dy pasoja;

1 pikë nëse analizon një pasojë;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 15 3 pikë

Model përgjigje

- Faktor shoqëror; Faktor kulturor;
- E drejta për të zgjedhur produktin që përfaqëson një mënyrë për të shprehur identitetin kulturor dhe për të ruajtur traditën; E drejta për të qenë të informuar lidhur me produktin; E drejta për zëvendësim të mallit nëse ka pasur dëmtime në momentin e shitjes; E drejta për siguri, përmbushja e standardeve të sigurisë ushqimore duke ofruar higjienë për përdorimin e synuar; Etj.
- Të mbajë përgjegjësi duke vlerësuar pasojat ekologjike. Konsumatorët mund të kontribuojnë në ruajtjen e traditave kulturore duke marrë parasysh gjithashtu qëndrueshmërinë afatgjatë të burimeve; Të ruajnë faturën pasi kemi bërë blerjen. Etj.

3 pikë nëse përcakton faktorin dhe shpjegon një të drejtë dhe një përgjegjësi;

2 pikë nëse përcakton faktorin dhe shpjegon një të drejtë ose një përgjegjësi; nëse shpjegon një të drejtë dhe një përgjegjësi;

1 pikë nëse përcakton faktorin; nëse shpjegon një të drejtë; nëse shpjegon një përgjegjësi;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 16 4 pikë

Model përgjigje

- Arsimimi i nxënësve ndikon në rritjen e mundësisë për përmirësimin e mirëqenies ekonomike. Një individ i mirëarsimuar ka më shumë mundësi të punësohet në profile pune të cilat ofrojnë kushte pune dinjitoze dhe/ose më shumë të ardhura.
- Arsimimi i nxënësve ndikon në socializimin social dhe kulturor. Edukimi me normat dhe vlerat e kulturës nxit tolerancën, gjithëpërfshirjen, empatinë, bashkëpunimin, të cilat janë të domosdoshme për ruajtjen e kohezionit në shoqëri.
- Arsimimi i nxënësve përmirëson nivelet e edukimit dhe parandalon fenomenet negative që dëmtojnë rendin dhe mirëqenien politike të vendit duke mundësuar pjesëmarrjen efektive dhe të përshtatshme në kulturën demokratike.
- Edukimi me vlerat e kulturës demokratike ndihmon në mbarëvajtjen e një shoqërie që udhëhiqet dhe funksionon mbështetur në parimet e shtetit të së drejtës.
- Etj.

4 pikë nëse analizon dy aspekte;

3 pikë nëse analizon një aspekt dhe përcakton një aspekt tjetër;

2 pikë nëse analizon një aspekt; nëse përcakton dy aspekte;

1 pikë nëse përcakton një aspekt;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Psikologji

Pyetja 27

3 pikë

Model përgjigje

- Presioni që Joni ka si rezultat i kërkesave të larta ndaj vetes, në këtë rast, për të arritur rezultate maksimale; Presioni i brendshëm për arritjen e qëllimit; Sfida për realizimin e synimit.
- Konflikti midis dy kërkesave për të zgjedhur midis karrierës profesionale dhe përgjegjësisë si nënë e re në përkujdesjen ndaj foshnjës.
- Frustracioni, rënia e fitimeve për shkak të konkurrencës; Kur pengohemi nga diçka për arritjen e qëllimit.

3 pikë nëse shpjegon burimin e stresit për tri situatat;

2 pikë nëse shpjegon burimin e stresit dy situata;

1 pikë nëse shpjegon burimin e stresit për një situatë;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 28

3 pikë

Model përgjigje

- Informacioni dhe zgjerimi i kulturës; Njohja me kultura të ndryshme dhe bashkëjetesa me diversitet;
- Edukimi i mirë dhe pa paragjykime nga familja, shkolla, shoqëria, si faktorë socializues që ndikojnë në përmirësimin e marrëdhënieve midis njerëzve.
- Kontakti social ndërmjet njerëzve. Përmes njohjes reciproke, zbulohen dhe bindjet, qëndrimet, opinionet e paargumentuara për të tjerët;
- Promovimi i barazisë midis njerëzve, përmes veprimtarive humane e sociale në shkollë;
- Ndikimi i medias, institucioneve fetare, shoqërisë civile, etj., në socializimin me vlerat universale;
- Etj.

3 pikë nëse vlerëson tri rrugë për humanizmin e marrëdhënieve njerëzore;

2 pikë nëse vlerëson dy rrugë për humanizmin e marrëdhënieve njerëzore;

1 pikë nëse vlerëson një rrugë për humanizmin e marrëdhënieve njerëzore;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 29

3 pikë

Model përgjigje

- **Inteligjenca kontekstuale**-Kjo inteligjencë ka të bëjë me aftësinë e njeriut për të përdorur inteligjencën e tij për të zgjidhur problemet që i dalin në situata specifike.
- **Inteligjenca eksperienciale**-Kjo inteligjencë ka të bëjë me aftësinë e njeriut për të përdorur përvojën që ka në botën që e rrethon. Ajo lidhet me përdorimin e shkathhtësive të të menduarit praktik, për shembull si të gjesh punë, si të mbijetosh, etj.
- **Inteligjenca komponenciale**-Kjo inteligjencë ka të bëjë me mënyrën që zgjedh njeriu për t'u marrë me informacionin, zgjidhje e problemeve komplekse duke i ndarë ato në pjesë. Kjo inteligjencë lidhet me zbatimin e mendimit krijues në situata të ndryshme.

3 pikë nëse përshkruan tri llojet e inteligjencave;

2 pikë nëse përshkruan dy llojet e inteligjencave;

1 pikë nëse përshkruan një nga llojet e inteligjencave;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 30
Model përgjigje

2 pikë

Forca e nevojës për sukses

Njerëzit që kanë motivacion të lartë dhe dëshirë të madhe për sukses synojnë arritje. Këta njerëz janë gati të përballen me vështirësitë dhe janë mjaft këmbëngulës.

Pritshmëria për sukses

Pritshmëritë që njeriu ka për veten ndikojnë në hartimin e planeve dhe qëllimeve që njeriu ka për të ardhmen e tij. Duke e njohur veten dhe vlerësuar apo duke pasur nevojën për vetaktualizim, të gjitha këto të ndihmojnë të vendosësh qëllime të qarta dhe realiste.

2 pikë nëse vlerëson dy faktorë;

1 pikë nëse vlerëson një faktor.

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 31
Model përgjigje

4 pikë

- 1) **Idi-** lidhet me instinktet me të cilat ne lindim. Këto instinkte kërkojnë të përmbushin dëshirat, ato janë pavetëdijshme.- “secili me cilësitë, impulset instinktive, format e kënaqësisë dhe dëshirën për aventura” i referohet shtysave të Idit që kërkojnë kënaqësi.
- 2) **Ego-** lidhet me aspektin racional. Ego ka për funksion nga njëra anë të përmbush dëshirat e idit dhe nga ana tjetër të përballen me kushtëzimet e superegos, që përmban rregulla. Ndaj ego lidhet me mundësinë e realizimit të veprimit bazuar në marrëdhënien id dhe superego. – “Vendimmarrjet e arsyetuara na ndihmojnë të gjejmë ekuilibrin”-tregon rolin e egos në vendimmarrje pas vlerësimit realist.
- 3) **Superego-** lidhet me sistemin moral të personalitetit. Parimet e mënyrës së organizimit të rregullave shoqërore, këshilla të cilat dikton shoqëria dhe vijnë si kërkesë për respektim nga agjentët socializues si familja, shkolla, grupi shoqëror etj., “shoqëria na imponon gjithmonë një mënyrë sjelljeje kolektive, e cila shërben si kriter për vlerësimin tonë”-pasqyron standardet morale të shoqërisë.
- 4) **Represioni** largon nga vetëdija kujtimet e trishta, lënduese, të hidhura, për në pavetëdije, duke bllokuar impulset e pavetëdijshme shqetësuese.

4 pikë nëse evidenton e përshkruan tri strukturat e personalitetit dhe përshkruan funksionin e mekanizmit mbrojtës;

3 pikë nëse evidenton e përshkruan tri strukturat e personalitetit; nëse evidenton e përshkruan dy strukturat e personalitetit dhe përshkruan funksionin e mekanizmit mbrojtës;

2 pikë nëse evidenton e përshkruan dy strukturat e personalitetit; nëse evidenton e përshkruan një strukturë të personalitetit dhe përshkruan funksionin e mekanizmit mbrojtës;

1 pikë nëse evidenton e përshkruan një strukturë të personalitetit; nëse përshkruan funksionin e mekanizmit mbrojtës;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 32
Model përgjigje

3 pikë

- **Psikologjia e personalitetit** – studion karakteristikat që i bëjnë njerëzit të dallohen nga njëri-tjetri, pra që kanë ndryshime midis tyre. Shpjegon ndryshimet individuale në sjellje, në tipare të personalitetit, temperamentit etj.

- **Psikologjia e zhvillimit** – studion ndryshimet fizike, mendore, sociale dhe emocionale që ndodhin tek njerëzit nga lindja deri në vdekje; Studion ndryshimet në peshë, gjatësi, mënyrën e të menduarit, marrëdhënie me të tjerët në faza të ndryshme të jetës.
- **Psikologjia sociale** – studion sesi njerëzit ndërveprojnë me njëri-tjetrin, mënyrën sesi ndikojnë tek njëri-tjetri dhe ndikimin e mjedisit në sjelljen e njerëzve. Ky drejtim studion ndikimin e besimeve, qëndrimeve dhe normave shoqërore në marrëdhëniet mes njerëzve.
- Etj.

3 pikë nëse përshkruan tri degët e psikologjisë;

2 pikë nëse përshkruan dy degët e psikologjisë;

1 pikë nëse përshkruan një degë të psikologjisë;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 33

2 pikë

Model përgjigje

Aspekti psikologjik

- Përvojat e kaluara: përvojat e kaluara të një personi dhe mënyra se si ata janë trajtuar në të kaluarën mund të ndikojnë në shprehjen e emocioneve tani. Një person që ka kaluar një përvojë jo të mirë në të shkuarën mund të ketë vështirësi në shprehjen e tyre.
- Personaliteti: njerëzit kanë personalitete të ndryshme, ndaj mënyra se si i shprehin emocionet nuk është njësoj. Personat me personalitet ekstrovert janë më të hapur dhe shprehës në shfaqjen e emocioneve, ndryshe nga personat me personalitet introvert, që kanë vështirësi në shprehjen e tyre.
- Trajtimi i emocioneve: njerëzit menaxhojnë emocionet në mënyra të ndryshme. Disa njerëz kanë aftësi të zhvilluara për të menaxhuar dhe shprehur emocionet në mënyra të shëndetshme, ndërsa të tjerë mund të kenë vështirësi në këtë aspekt.
- Niveli i stresit dhe i ankthit: niveli i stresit dhe ankthit ndikon në mënyrën e shprehjes së emocioneve. Në momente stresi apo ankthi kontrolli i emocioneve bëhet i vështirë.

Aspekti kulturor

- Shprehja e emocioneve lidhur me sistemin normativ, vlerat e shoqërisë dhe pritshmëritë e mjediseve sociale në të cilat jetojmë.
- Vlerat dhe normat: si pjesë e shoqërisë, çdo individ socializohet lidhur me mënyrën e shprehjes së emocioneve ose me fshehjen e tyre. Disa kultura vlerësojnë shprehjen e emocioneve si shenjë e sinqeritetit, e disa kultura të tjera si shenjë dobësie.
- Komunikimi: disa kultura inkurajojnë komunikimin e hapur dhe të drejtpërdrejtë të emocioneve. Disa shoqëri e vlerësojnë dhe inkurajojnë shprehjen e emocioneve, ndërsa në disa të tjera mund të jetë më e rëndësishme përmbajtja ndaj normave, kundrejt shprehjes së emocioneve. Në mjediset ku nuk inkurajohet komunikimi i drejtpërdrejtë, gjuha e trupit mund të përcjellë më shumë informacion për emocionet.

Etj.

2 pikë nëse analizon dy faktorë;

1 pikë nëse analizon një faktor;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.